

# Zbatimi i Rekomandimit të Këshillit të Evropës për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNJ): situata aktuale

## Standardi i artë për Institucione efektive, të pavarura dhe pluraliste të të Drejtave të Njeriut.

Marsi i vitit 2021 shënoi një moment të rëndësishëm: Komiteti i Ministrave miratoi Rekomandimin ([CM 2021/1](#)) në lidhje me Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNJ). Ky zhvillim afirmoi Institucionet Evropiane të të Drejtave të Njeriut (IKDNJ) dhe rrjetin e tyre rajonal ENNHRI (Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, si pilarë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. ENNHRI është standarti evropian për pavarësinë, pluralizmin dhe efektivitetin e institucioneve të të drejtave të njeriut, në përputhje me vlerat globale të [Parimeve të Parisit të OKB-së](#).

## Studimi i ENNHRI-it: vlerësimi i zbatimit të Rekomandimit.

Studimi i ENNHRI-t përmban një analizë specifike me praktikën e mira dhe rekomandimet për secilin shtet anëtar të Këshillit të Evropës, si dhe gjetje të përgjithshme mbi rajonin.

Për të siguruar rigorozitetin dhe besueshmërinë e studimit, gjetjet janë marrë nga tre burime: raportet e IKDNJ-ve; raportet e [Nën-Komitetit të Akreditimit](#) (SCA) të Aleancës Globale të IKDNJ-ve; dhe informacionet nga organet e pavarura të Këshillit të Evropës.

## Koha e duhur për të promovuar të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës

Këshilli i Evropës, duke nxitur dhe vënë në zbatim rezultatet e Samitit më të fundit, atij të të katërt, do të përforcojë misionin e tij kryesor: promovimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Evropë. IKDNJ-të dhe ENNHRI kanë një rol kyç në arritjen e këtij qëllimi: Rekomandimi ofron bazamentin për mundësimin e arritjes së tij.

Inkurajojmë vijimin e ndjekjes së gjetjeve të studimit në nivel kombëtar dhe rajonal, për të fuqizuar IKDNJ-të, e së bashku me to edhe të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

## Çfarë po shkon si duhet?



Ekziston një **familje e IKDNJ-ve që vetëm rritet** në vendet e Këshillit të Evropës me 46 shtete anëtare. Ndër to 28 IKDNJ janë të akredituara me statusin A, ndërsa 12 të tjerat janë institucione që po ndjekin hapat drejt akreditimit me statusin A.



Autoritetet **në përgjithësi janë të ndërgjegjësuar** mbi IKDNJ-të, dhe përgjithësisht iu ofrojnë akses të përshtatshëm në informacion, politikëbërje dhe legjislacion.



IKDNJ-të kanë **mandate të konsoliduara për të kontribuar në sistemin e drejtësisë**, përfshirë promovimin, trajtimin e ankesave individuale, litigim strategjik, dhe ndërhyrje si palë të treta përpara gjykatave.

## Çfarë mund të përmirësohet?



**Implementimi i proceseve transparente, pluraliste dhe bazuar në merita në përzgjedhjen e drejtuesve të IKDNJ-ve.** Thelbësore në pavarësinë dhe efektivitetin e IKDNJ-ve, kjo gjetje është e vlefshme për shumicën e vendeve anëtare.



**Garantimi i burimeve të përshtatshme** për IKDNJ-të në ushtrimin e plotë të mandatit të tyre dhe **alokimi i burimeve shtesë** për çdo kompetencë tjetër që mund t'u jepet, përmes **linjave buxhetore të pavarura**.



**Garantimi i ndjekjeve në kohë dhe të arsyetuara të rekomandimeve të IKDNJ-ve** duke hartuar rregullore dhe procese të përshtatshme.

## Forcimi i mbështetjes për angazhim më të plotë të IKDNJ-ve në Këshillin e Evropës



Nisur nga praktikatat e mira dhe sfidat me të cilat përballen të gjitha shtetet anëtare, vlerësohet e arsyeshme ngritja e një **programi gjithpërfshirës të Këshillit të Evropës në mbështetje të IKDNJ-ve**, përfshirë këtu mbështetjen për vende specifike, shkëmbimin e eksperiencave midis IKDNJ-ve dhe projektet e binjakëzimit.



IKDNJ-të janë të angazhuara në bashkëpunim me të paktën 13 organizma të Këshillit të Evropës, dhe **qëllimi thelbësor është thellimi i angazhimit dhe bashkëpunimit ndërmjet IKDNJ-ve dhe ENNHRI-t.** Mbështetja e vijueshme dhe e dedikuar për IKDNJ-të në Sekretariatit të Këshillit të Evropës (DG I) do të përbente një hap të rëndësishëm në këtë drejtim.